



HERTFORDSHIRE
Modern Slavery Partnership

Instruction to Professionals: Please check that the individual presenting is able to read and do not let them take this flyer home with them. If you do, you are potentially putting them at risk.

Ndihma për të rriturit/fëmijët e rritur (të moshës 16-18 vjeç) që shfrytëzohen në Mbretërinë e Bashkuar: Broshura informuese

Lexoni dhe ndiqni udhëzimet.

Në Mbretërinë e Bashkuar, do të vlerësohet se po shfrytëzoheni në rrethanat e mëposhtme:

- Ju nuk merrni pagë ose merrni një pagë shumë të ulët për punën tuaj dhe/ose punoni me orare jashtëzakonisht të zgjatura.
- Dikush merr paratë tuaja.
- Ju detyroheni të punoni ose të kryeni veprime seksuale.
- Ju mbaheni në robëri ose kundër vullnetit tuaj.
- Nuk mund të largoheni nga vendbanimi, mbikëqyreni dhe/ose nuk mund të lëvizni lirisht.
- Jeni sjellë në Mbretërinë e Bashkuar për të punuar për dikë që tani ju kërcënon, frikëson, lëndon ose detyron të bëni punë ose gjëra të tjera që nuk dëshironi t'i bëni.

Shënoni kutinë me shenjën e zgjedhjes nëse përgjigjeni me "po" për pyetjet e mëposhtme:

- A jeni në rrezik?
- A mund të flisni pa u rrezikuar?
- Keni nevojë për ndihmë?
- Keni nevojë për një përkthyes ose një avokat?

Në Mbretërinë e Bashkuar, mund të jeni duke u shfrytëzuar nëse përgjigjeni me "po" për ndonjë nga pyetjet e mëposhtme. Shënoni ato që janë të vlefshme për ju:

- Po ju detyrojnë të punoni pa pagë ose për një pagë të ulët?
- Nëse po punoni, a po paguheni më pak se 7 £ për orë?
- A po punoni më shumë se 48 orë në javë?
- A po detyroheni të kryeni veprime seksuale në punë ose si individ?
- A po jetoni në kushte jetese jashtëzakonisht të papastra apo të varfra?
- A po kontrolloheni nga të tjerët? (Ndonjëherë ky mund të jetë një i afërm, mik ose partner.)

For more information on human trafficking/modern slavery and additional resources, please consult the Hertfordshire Modern Slavery Partnership website: www.stopexploitationherts.org.uk/professionals/professionals.aspx.

- A ju janë marrë dokumentet e identifikimit ose sende të tjera personale të vlefshme?
- Nëse do t'ju ndihmoja sot, a do të kishte pasoja për ju ose familjen tuaj?
- A jeni të shqetësuar se dikush mund t'ju lëndojë ju ose familjen tuaj?
- A jeni në borxh me dikë? Apo i detyroheni dikujt para?
- A po jua merr dikush paratë?
- Kam një problem tjetër.

Mund të ndjeheni të frikësuar, të pafuqishëm dhe të vetmuar. Sidoqoftë, ka ndihmë të disponueshme për ju dhe ju keni të drejta dhe mundësi zgjedhjeje.

Nëse zbulohet se jeni shfrytëzuar në Mbretërinë e Bashkuar, ju keni të drejtën për të marrë ndihmë të pavarur, emocionale, mjekësore dhe praktike nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Kjo mbështetje mund të ofrohet në disa mënyra të ndryshme, duke përfshirë:

- gjetjen e strehimit të sigurt të përkohshëm për ju.
- ndihmën me trajtime mjekësore për ju.
- ndihmën e një personi për të përballuar eksperiencën që po kaloni.
- ofrimin e një përkthyesi/interpreti për t'ju ndihmuar të komunikoni në anglisht.
- mbrojtje.
- këshillim ligjor të pavarur.
- pagesa asistence.

Kini parasysh: ndonjëherë ka kufizime për këto të drejta.

Si punonjës në Mbretërinë e Bashkuar, ju keni të drejtën për:

1. Pagesë të paktën 8,21 £ në orë nëse jeni mbi 25 vjeç, 7,70 £ në orë nëse jeni 21 deri në 24 vjeç dhe 6,15 £ në orë nëse jeni 18 deri në 20 vjeç.
2. Maksimumi 48 orë pune në javë, duke përfshirë kohën shtesë.
3. Një pushim gjatë ditës së punës të paktën 20 minuta kur punoni më shumë se 6 orë në ditë.
4. Pushime vjetore të paguara për një numër minimal javësh, duke filluar nga dita juaj e parë e punës.
5. Informacione për sigurinë dhe shëndetin në punë, trajnime, veshje mbrojtëse dhe çdo zëvendësim të nevojshëm pa pagesë, kur është e nevojshme.
6. Detajet e kushteve të përgjithshme me shkrim për punësimin tuaj nëse jeni punësuar për më shumë se 1 muaj.
7. Pagesë në rast sëmundjeje, e cila do të detajohet në kontratën tuaj të punësimit.

For more information on human trafficking/modern slavery and additional resources, please consult the Hertfordshire Modern Slavery Partnership website: www.stopexploitationherts.org.uk/professionals/professionals.aspx.